



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI

Në bazë të nenit 12.2 shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neneve 13.1 shkronja a dhe 44.1 të Ligjit për tokën bujqësore nr. 02/L-26, neneve 6.2 dhe 8.6 të Udhëzimit Administrativ për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, nr. 41/2006 të datës 27.12.2006, dhe neneve 15.2 shkronja d dhe 19 shkronja b të Statutit të Komunës së Podujevës, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 25 nëntor 2015, miratoi,

VENDIM

PËR LEJIMIN E NDËRRIMIT TË DESTINIMIT TË PËRHERSHËM TË TOKËS BUJQËSORE NË TOKË NDËRTIMORE

Neni 1

Hazir Mehmet Sylja nga fshati Gllamnik Komuna e Podujevës, në cilësinë e pronarit, i lejohet ndërrimi i përhershëm i destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të paluajtshmërisë së evidentuar sipas ngastrës kadastrale nr. 01704-1 kultura – bujqësore - arë kl. 4 vendi i quajtur Lahovit-Tepe në sipërfaqe prej 3899 m², certifikata pronësore nr. 08/714/82380 të datës 16.09.2015, Zona kadastrale Gllamnik.

Neni 2

Pronari, në emër dhe interes të të cilit bëhet ndërrimi i destinimit nga toka bujqësore në tokë ndërtimore obligohet që paluajtshmërinë përkatëse ta shfrytëzojë vetëm për ndërtimin e objektit – fermë e pulave dhe nuk mund ta përdorë për qëllime të tjera.

Neni 3

Regjistrimin, në librat kadastral, të pronës përkatëse për ndërrim të destinimit nga toka bujqësore në tokë ndërtimore në emër të pronarit e bënë Drejtoria e Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë.

Neni 4

Vendimi bëhet përfundimtar pas plotësimit të kushteve të përcaktuara në nenin 8.6 të Udhëzimit Administrativ për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, nr.41/2006, përkatësisht pas marrjes së pëlqimit nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 5

Zbatimin e vendimit e bëjnë Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Neni 6

Vendimi hynë në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë përkatësisht regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 01-006-99948
Podujevë,
25 nëntor 2015



Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi